



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:036633

Datë: 18.02.2025

Numri i dokumentit: 06863097

Ac.nr.3055/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Liridon Maloku dhe Naim Meholli, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Xhennet Shantir, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Y.I, K.R-SH, S.V, E.M dhe A.K, të gjithë nga Vushtrria, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Veton Uka, avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Salihu, avokat nga Vushtrria, me objekt kontesti kompensim i ushqimit për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.***/2021, të datës 24.04.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 07.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.***/2021, të datës 24.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.***/2021, të datës 24.04.2023, ka vendosur si në vijim: *I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve Y.I, K.R-SH, S.V, E.M dhe A.K, të gjithë nga Vushtrria, DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë, paditësit Y.I, për periudhën nga data 23.10.2019 e deri me datë 09.11.2021, (373 ditë pune) t'ia paguaj shumën prej 746.00 euro, paditëses K.R-SH, për periudhën nga data 01.11.2021 e deri me datë 09.11.2022, (235 ditë pune), t'ia paguaj shumën prej 470.00 euro, paditëses S.V, për periudhën nga data 25.06.2021 e deri me datë 09.11.2022, (310 ditë pune), t'ia paguaj shumën prej 620.00 euro, paditëses E.M, për periudhën nga data 01.11.2021 e deri me datë 09.11.2022, (235 ditë pune), t'ia paguaj shumën prej 470.00 euro dhe paditëses A.K, për periudhën nga data 01.11.2021 e deri me datë 09.11.2022, (235 ditë pune), t'ia paguaj shumën prej 470.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 08.11.2022 (precizimi i padisë) për paditësin Y.I, ndërsa për*

paditëset K.R-SH, S.V, E.M dhe A.K, llogaritet nga data 20.02.2023 (zgjerimi i padisë) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, për përpilimin e zgjerimit të padisë shumë prej 312.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej 20.00 euro, apo shumë e përgjithshme prej 436.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimin e ankimuar ta anulon dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore konform dispozitave ligjore ose ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën t'ia kthejë në rigjykim organit të shkallës së parë.

Paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, brenda afatit ligjor kanë paraqitur përgjigje në ankesë, me të cilën e kontestojnë ankesën e ushtruar si të pabazuar, me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzon ankesën e të paditurës si të pathemeltë dhe ta vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, C.nr.*/2021, të datës 24.04.2023.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194,195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se fillimisht paditësi Y.I, përmes të autorizuarit të tij me datë 25.02.2021 ka parashtruar padi, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që t'ia kompensoj shpenzimet e ushqimit në shumë prej 400.00 euro, për periudhën nga data 23.10.2019 e deri me datë 22.02.2021, (200 ditë pune). Ndërsa me parashtrësën për precizimin e padisë të datës 08.11.2022, ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për periudhën nga data 23.10.2019 e deri me datë 09.11.2021, (373 ditë pune). Kurse me parashtrësën e datës 20.02.2023, është zgjeruar padia në aspektin subjektiv ashtu që si paditës janë përfshirë edhe K.R-SH, S.V, E.M dhe A.K. Paditësit K.R-SH, S.V, E.M dhe A.K, kanë kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që t'ua kompensoj shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe atë për paditësen për periudhën nga data 01.11.2021 e deri me datë 09.11.2022, (235 ditë pune), t'ia paguaj shumë prej 470.00 euro, paditëses S.V, për periudhën nga data 25.06.2021 e deri me datë 09.11.2022, (310 ditë pune), t'ia paguaj shumë prej 620.00 euro, paditëses E.M, për periudhën nga data 01.11.2021 e deri me datë 09.11.2022, (235 ditë pune), t'ia paguaj shumë prej 470.00 euro dhe paditëses A.K, për periudhën nga data 01.11.2021 e deri me datë 09.11.2022, (235 ditë pune), t'ia paguaj shumë prej 470.00 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas pranimit të përgjigjes në padi nga e paditura dhe pas vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, gjykata në bazë të nenit 398 të LPK-së, pa caktuar seancë gjyqësore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.*/2021, të datës 24.04.2023 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga kontrata e punës dhe vërtetimet e lëshuara nga SH.F.M.U “N”, në N, Komuna e Vushtrrisë dhe atë për paditësin Y.I, Kontrata numër **/18, e datës 13.09.2018, për paditësen K.R-SH, Vërtetimi i datës 09.11.2021, për paditësen S.V, Vërtetimi i datës 09.11.2021, për paditësen E.M, Vërtetimi i datës 09.11.2021 dhe për paditësen A.K, Vërtetimi i datës 09.11.2021. Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë. Gjykata në bazë të vërtetimit me nr. ref. **/21, të datës 10.11.2021, i lëshuar nga SH.F.M.U “Q” në M, Komuna e Vushtrrisë, vërtetoi se paditësi Y.I është në marrëdhënie pune pranë të njëjtës dhe për periudhën kohore prej datës 23.10.2019 e deri me datë 09.11.2021, ka gjithsej 373 ditë pune, periudhë për të cilën paditësi kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë. Në bazë të Vërtetimit të datës 09.11.2021, të lëshuar nga SH.F.M.U “N” në N, Komuna e Vushtrrisë, vërtetoi se paditësja K.R-SH është në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria e saj në punë për periudhën kohore nga data 01.11.2021 deri me datë 09.11.2022, është gjithsej 235 ditë pune, periudhë për të cilën paditësja kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë. Gjykata në bazë të Vërtetimit të datës 09.11.2021, të lëshuar nga SH.F.M.U “N” në N, Komuna e Vushtrrisë, vërtetoi se paditësja S.V është në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria e saj në punë për periudhën kohore nga data 26.06.2021 deri me datë 09.11.2022, është gjithsej 310 ditë pune, periudhë për të cilën paditësja kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë. Në anën tjetër, gjykata përmes Vërtetimit të datës 09.11.2021, të lëshuar nga SH.F.M.U “N” në N, Komuna e Vushtrrisë, vërtetoi se paditësja E.M është në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria e saj në punë për periudhën kohore nga data 01.11.2021 deri me datë 09.11.2022, është gjithsej 235 ditë pune, periudhë për të cilën paditësja kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë. Po ashtu gjykata përmes Vërtetimit të datës 09.11.2021, të lëshuar nga SH.F.M.U “N” në N, Komuna e Vushtrrisë, vërtetoi se paditësja A.K është në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria e saj në punë për periudhën kohore nga data 01.11.2021 deri me datë 09.11.2022, është gjithsej 235 ditë pune, periudhë për të cilën paditësja kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë. Gjykata kishte gjetur se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si punëtor të arsimit t’ia kompensoj shujtat ditore gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, ditët e punës për secilin paditës, të vërtetuara nga vetë punëdhënësi, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 €, duke i njohur shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nenit 87 të Ligjit të Punës, vendimin mbi kamatën e ka bazuar në nenin 382 par. 2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. ***/2020, të datës 02.12.2020, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika e) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me aktgjykimin e ankimuar është vendosur për

kërkesat sipas padisë të cilat janë paraqitur brenda afateve kohore të ligjshme, ku paditëset K.R-SH, E.M dhe A.K kanë kërkuar kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën nga data 01.11.2021 deri 09.11.2022, ndërsa paditësi Y.I për periudhën nga data 23.10.2019 deri 09.11.2021 dhe paditësja S.V për periudhën nga data 25.06.2021 deri 09.11.2022, pra paditësit kërkesat e tyre i kanë parashtruar brenda periudhave kohore që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e kanë paraqitur në gjykatë më 25.02.2021 dhe zgjerimin e padisë me datë 20.02.2023. Andaj në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesëpadisë së paditësve, ashtu siç pretendon e paditura.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave nga neni 182 par. 2 pika o) të LPK-së, për faktin se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk e ka tejkaluar kërkesëpadinë e paditësve, ashtu siç pretendon e paditura duke konsideruar se në aktgjykimin e ankimuar gjykata i është referuar Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021, e që paditësit në padi i janë referuar asaj të vitit 2017. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, ky pretendim i palës së paditur është i pabazuar, për shkak se konform dispozitave të procedurës kontestimore, konkretisht konform nenit 2 paragrafi 2 të LPK-së, gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale. Andaj në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me tejkallim të kërkesëpadisë nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika h) dhe i) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar pa mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, duke aplikuar dispozitat e nenit 398 të LPK-së, pasi që në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor nga ana e gjykatës. Pra, kërkesëpadia e paditësve ishte qartazi e themeltë, e njëjta bazohej në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Arsimit, ndërsa shumën e kompensimit gjykata ka vërtetuar nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimet e lëshuara nga vet paditësit, andaj edhe nuk ka pasur pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike se paditësi Y.I është në marrëdhënie pune në SH.F.M.U “Q” në M, Komuna e Vushtrrisë, ndërsa paditësit tjerë K.R-SH, S.V, E.M dhe A.K janë në marrëdhënie pune në SH.F.M.U “N” në N, Komuna e Vushtrrisë. Ndërsa në bazë të vërtetimeve e lëshuara nga e paditura gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Y.I për periudhën kohore prej datës 23.10.2019 e deri me datë 09.11.2021, ka gjithsej 373 ditë pune, paditësja K.R-SH për periudhën kohore nga data 01.11.2021 deri me datë 09.11.2022, ka gjithsej 235 ditë pune, paditësja S.V për periudhën kohore nga data 26.06.2021 deri me datë 09.11.2022, ka gjithsej 310 ditë pune, paditësja E.M për periudhën kohore nga data 01.11.2021 deri me datë 09.11.2022, ka gjithsej 235 ditë pune, ndërsa paditësja A.K për periudhën kohore nga data 01.11.2021 deri me datë 09.11.2022, ka

gjithsej 235 ditë pune, periudhë për të cilën paditësit kërkojnë kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 90 paragrafin 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*. Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë, parashihet se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, andaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjyimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), të datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, të cilat kontrata kanë qenë në fuqi me rastin e lindjes të së drejtës për të parashtruar kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që nënkupton se këto Kontrata shërbejnë si akt nga të cilat buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko-civil, ndaj paditësve në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit - shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragrafin 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën e gjykuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr.*/2020, të datës 02.12.2020, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 453.1 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2021:036633
Datë: 18.02.2025
Numri i dokumentit: 06863097

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3055/2023, me datë 07.02.2025

Bashkëpunëtore profesionale
Xhennet Shantir

Kryetare e kolegjit
Halide Reka